



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

VENDIM  
Nr. 123, Datë 26.12.2019

PËR

MIRATIMIN E MODELIT TË REGJISTRIT TË FJETJES NË HOTELE

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin nr.9920 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr.9632 Për sistemin e taksave vendore, të ndryshuar, Neni 9, pika 3 dhe neni 26, pika 6, Këshilli i Bashkisë Lezhë, pas diskutimit;

VENDOSI

1. Të miratojë modelin e Regjistrit të Fjetjes në Hotele, sipas pasqyrës bashkëlidhur këtij vendimi, që do të përdoret nga subjektet private, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e Hoteleri-Turizmit, për ofrimin e shërbimit “Hoteleri”.
2. Çdo subjekt i tillë sipas pikës 1 të këtij vendimi, ka detyrimin për pajisjen me regjistrin përkatës dhe pasqyrimin e të dhënave të përdishme aty, duke filluar nga data 01 Shkurt 2020 e në vijim.
3. Ngarkohet Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Lezhë, që të njoftojë zyrtarisht të gjithë subjektet, që ushtrojnë aktivitetin në fushën e Hoteleri Turizëm për plotësimin e këtij detyrimi, në respekt të afatit të sipërcituar.
4. Në rast të mos tërheqjes së këtij regjistri pranë Bashkisë Lezhë, ngarkohen strukturat e Sektorit të Regjistrimit & Vlerësimit, pranë Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore për evidentimin e atyre subjekteve dhe kryerjen e procesit të vlerësimit me vendosjen e gjobës me vlerë 5.000 lekë / ditë vonese, për çdo rast.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes dhe i shtrinë efektet e tij nga data 1 Shkurt 2020 e në vijim.

KRYETARI  
ERNËST RAKAJ

